



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**  
**Nr. 940, datë 17. 08. 2009**

**Për**  
**“Miratimin për konsultim publik të projektaktit normativ “Udhëzues për procedurat e këshillimit me publikun”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- |                |        |         |
|----------------|--------|---------|
| 1. Z. Ilir     | Shehu  | Kryetar |
| 2. Z. Afrim    | Tonuzi | Anëtar  |
| 3. Znj. Edlira | Kasaj  | Anëtar  |
| 4. Z. Ilir     | Zela   | Anëtar  |
| 5. Z. Jetmir   | Karini | Anëtar  |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 17. 08. 2009, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, me objekt:

**“Shqyrtimi i projektaktit normativ për konsultim publik “Udhëzues për procedurat e këshillimit me publikun”,**

mori në shqyrtim materialet shkresore të propozuar nga Drejtoria Juridike të përbëra nga:

- Draft Rregullore “Për procedurat këshillimit me publikun” (*Projektakti*);
- Relacioni shpjegues mbi projektaktin (*Relacioni*);
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485 (*Projektvendimi*).

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja p) e nenit 8, neni 110 dhe pika 1 e nenit 115, të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

**V Ë R E H E T se :**

1. Dokumentacioni i paraqitur nga pikpamja formale procedurale është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 10/1 të Rregullores së Brendshme.
2. Projektakti është një udhëzues që AKEP-i në zbatim të kompetencës të përcaktuar në shkronjën p) të nenit 8 të ligjit nr. 9918 duhet ta nxjerri me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor me aktet e nevojshme nënligjore, lidhur me procedurën për kryerjen e këshillimit me publikun sipas nenit 110 të këtij ligji.
3. Projektakti është hartuar nga Drejtoria Juridike në bashkëpunim me konsulentin “Development Dynamics” L.td. në kuadër të projektit “EBRD/EU Communications Regulatory Development Project”.
4. Përmbajtja e projektaktit është në përputhje me parimet dhe procedurat administrative të parashikuara në ligjin nr. 8485, si dhe përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 110 të ligjit nr. 9918.

#### **ATEHERE:**

Për sa më sipër, duke patur parasysh se projektakti përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në bazën ligjore referuese, si dhe përbën një akt nënligjor të rëndësishëm për kryerjen e procedurave për këshillimin me publikun, KD i AKEP bazuar në pikën 1 të nenin 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

#### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë projektaktin normativ për konsultim publik “Udhëzues për procedurat e këshillimit me publikun” sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të kryhet procesi i këshillimit publik në përputhje me nenin 110 të ligjit nr. 9918, duke e publikuar sipas procedurës në faqen zyrtare [www.aekp.gov.al](http://www.aekp.gov.al) dhe të njoftohen palët e interesuara për të paraqitur mendimin e tyre me shkrim brenda 60 ditëve pas datës së miratimit të këtij vendimi;

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

#### **KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES**

**Ilir SHEHU**

#### **Anëtarë të Këshillit Drejtues:**

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**